



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ___/___/2021

V E N D I M

Nr. 29, datë 16/02/2021

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 78, datë 20.07.2020, e znj. G.M., ku pretendohet diskriminim për shkak të “*përkatësisë në një grup të veçantë*”¹, nga ana e Assist sh.p.k.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi²,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në ankesë, si dhe mbështetur në dokumentacionin bashkëlidhur saj, rezulton se ankuesja punon pranë Assist sh.p.k., që prej muajit dhjetor 2018, në pozicionin e operatorit telefonik. Ankuesja shprehet se që në fillim të punësimit të saj pranë kësaj shoqërie, ka konstatuar se të drejtat e punonjësve nuk respektoheshin dhe mbi ta ushtrohej vazhdimisht presion për largim nga puna, nëse ndonjë prej tyre nuk punonte orë jashtë orarit, apo ngrinte zërin për padrejtësitë e kryera ndaj tij. Sipas ankueses, punonjësit shpesh herë penalizohen nga eprorët e tyre pranë kësaj shoqërie, duke mos u aprovuar lejet vjetore në datat e kërkuara nga ta. Njëkohësisht, ankuesja e informoi Komisionerin mbi faktin se punonjësit e Assit sh.p.k i kanë detyruar punonjësit të nënshkruajnë një akt, nëpërmjet së cilit ata i jepnin shoqërisë miratimin e tyre, për të patur akses në të dhënat e tyre sensitive, përfshirë këtu

¹ Përkatësia në grup të veçantë konsiston në anëtarësinë e ankueses në Sindikatën Solidariteti, fakt që vërtetohet nëpërmjet aktit Formular Anëtarësimi nr. 58, datë 29.11.2019, të Sindikatës Solidariteti.

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

orientinin seksual, bindjet fetare, politike, si dhe mbi të dhënat e llogarive bankare të familjarëve të tyre. Ajo shprehet se ndaj tyre është ushtruar presion për nënshkrimin e një dokumenti të tillë. Ky presion ka ndaluar së ushtruari, vetëm pasi kjo çështje u bë e ditur, tek Komisioneri për të Drejtën e Informimit. Pas këtij episodi, ajo është paralajmëruar nga menaxheri i saj, për të mos u shprehur mbi mos dakordësitë e saj me politikat e kompanisë.

Në vijim, ankuesja sqaron se në datën 29.11.2019 është bërë anëtare e Sindikatës Solidariteti, sindikatë kjo që mbron interesat e punonjësve të Call Center, fakt që ajo ua ka bërë të ditur supervizorëve të saj. Që nga ky moment, ndaj saj ka nisur diskriminimi nga ana e punëdhënësit, për shkak të “përkatësisë në një grup të veçantë”. Znj. G.M. shprehet se ka patur disa konflikte verbale me menaxherin e shoqërisë, z. F.O.

Ankuesja sqaron se në datën 07.04.2020, ndaj saj është marrë masa disiplinore “vërejtje me shkrim”. Procedura disiplinore ndaj znj. G.M. ka filluar pas raportimit të bërë nga supervizori i saj, z. F.O. Sipas këtij raportimi, ankuesja ka shkëlur nenet 7.2(f) dhe 7.2(g) të Rregullores së Shoqërisë, duke kryer 6 mungesa të pajustificuara për muajin mars 2020 dhe 4 mungesa sërisht të pajustificuara për muajin prill 2020. Këto data përkojnë me muajt e parë të periudhës së pandemisë, ku ajo fillimisht u udhëzua të punonte nga shtëpia. Në datën 13 mars 2020, ankuesja shprehet se është realizuar një takim ndërmjet saj, përfaqësuesve të Burimeve Njerëzore të shoqërisë, si dhe kryetarit të Sindikatës, ku ajo bën pjesë. Në këtë takim, ajo ka parashtruar arsyet e saj për mosparaqitje në punë, një ndër të cilat sipas ankueses është se supervizorja e saj A.M.e kishte njoftuar se ardhja në punë gjatë periudhës së pandemisë nuk ishte e detyrueshme.

Në datën 30 prill 2020, Assist sh.p.k. e ka njoftuar znj. G.M. se dëshiron të shkëpusë marrëdhëniet e punës me të dhe se arsyen do t’ia bënin të ditur në datën 05.05.2020. Ankuesja pretendon se ende pa u marrë vendimi për ta larguar nga puna, supervizorja e re e ka përjashtuar nga grupi i punës, duke krijuar për të pamundësi komunikimi lidhur me oraret apo çdo lloj njoftimi që mund të bëhej në këtë grup pune. Njëkohësisht, ajo është përjashtuar nga mbledhjet e grupit të punës, aq sa nuk dinte më se cili ishte supervizori i saj, apo kujt mund t’i kërkonte asistencë rreth procesit të punës.

Në vijim ankuesja pretendon se në datën 04.05.2020, Kompania e ka ftuar për të nënshkruar një dokument, sipas së cilit znj. G. M. pranonte se po largohej nga puna si pasojë e një rimbursimi të paautorizuar nga shoqëria. Ankuesja nuk e ka nënshkruar këtë akt, por ka kërkuar e-maillet e Vodafone Italia që vërtetonin një gjë të tillë, të cilat nuk iu vunë asnjëherë

në dispozicion. Një fakt e tillë e ka bindur znj. G.M. se qëllimi i vetëm i shoqërisë Assist sh.p.k. ka qenë largimi i saj nga puna.

Në datën 06.05.2020, ankueses i është komunikuar verbalisht nga ana e personave përgjegjës të Shoqërisë Assist sh.p.k, që marrëdhëniet e punës me të, do të ndërpriten në datën 06.07.2020. Në vijim, ankuesja pretendon se nuk është pranuar që të vijë më në punë, pasi fillimisht paraqitja e saj në punë është pritur shumë keq nga menaxheri i saj, e në vijim roja i godinës nuk e ka lejuar atë të ketë akses në ambientet e punës.

Për sa më sipër, ankuesja pretendon diskriminim për shkak të përkatësisë në një grup të veçantë.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në datën 18.11.2020, kanë hyrë në fuqi ndryshimet ligjore, të miratuara me ligjin nr. 124/2020 *“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10221, datë 04.02.2020 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”*”³. Meqënëse çështja objekt i këtij shqyrtimi administrativ është paraqitur përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 124/2020, atëherë Komisioneri vlerëson se çështja duhet të shqyrtohet sipas parashikimeve të ligjit nr. 10221/2010 *“Për mbrojtjen nga diskriminimi”*.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, gërma “c”, të ligjit nr. 10221/2010 *“Për mbrojtjen nga diskriminimi”*⁴, që i jep të drejtën për të hetuar dhe shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë, sipas parashikimeve të këtij ligji.

Ligji nr.10 221/2010 *“Për mbrojtjen nga diskriminimi”*, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, por në mënyrë të shprehur neni 1, i ligjit parashikon mbrojtjen nga diskriminimi për shkak të aftësisë së kufizuar, duke përcaktuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen*

³ Ligji nr.124/2020 *“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10221, datë 04.02.2020 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”*, është botuar në Fletoren Zyrtare Nr.191, datë 03.11.2020.

⁴ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Neni 3, i Ligjit nr.10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, ndalon çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur nga neni 1, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi. Ndërsa në Kreun II, të ligjit parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e të punësimit. Ky ligj në nenin 12, pika 1, të tij parashikon se: “1. Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: a) shpalljen e vendeve të lira të punës; b) rekrutimin dhe përzgjedhjen e punëmarrësve; c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës; ç) anëtarësinë në sindikata dhe mundësinë për të përfituar nga lehtësitë që siguron kjo anëtarësi.”

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenti 7 të LMD-së, garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Hapat procedurialë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

- A. Pas analizimit të ankesës nr. 78, datë 20.07.2020, e znj. G.M., u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

B. Mbështetur në nenin 33, pika 7⁵, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua subjekteve përkatëse me shkresën nr. 999/1, datë 28.07.2020, ku kërkohej informacion, si më poshtë vijon:

- Informacion i përgjithshëm mbi pretendimet e ankueses;
- Kontrata e individuale e punës së ankueses me Assist sh.p.k.;
- Kopje e Rregullores së Brendshme të Shoqërisë;
- Praktikrat për dhënien e masës disiplinore ndaj znj. G.M., ku të përfshihen akti i njoftimit, procesverbali i takimit, observacionet e ankuesit dhe akti, nëpërmjet së cilit jepet masa disiplinore;
- Informacion nëse znj. G.M. e ka kundërshtuar me shkrim pranë punëdhënësit/osë në gjykatë, masën disiplinore të dhënë ndaj saj;
- Informacion, nëse në të kaluarën ndaj ankueses janë dhënë masa të tjera disiplinore;
- Vlerësimet e performancës në punë të ankueses;
- Praktika e zgjidhjes së kontratës së punës me ankuesen, ku të përfshihen: akti i njoftimit, procesverbali i takimit, observacionet e ankueses dhe akti nëpërmjet së cilit jepet zgjidhet kontrata e punës;
- Informacion nëse zgjidhja e kontratës së punës me ankuesen është bërë objekt shqyrtimi gjyqësor;
- Informacion mbi numrin e operatorëve të Assist sh.p.k. që janë anëtarë të Sindikatës Solidariteti apo ndonjë sindikatë tjetër që mbron interesat e tyre;
- Informacion mbi numrin e operatorëve të tjerë, të cilët janë anëtarë sindikate dhe u është zgjidhur kontrata individuale e punës, nga muaji gusht 2019 e në vijim;

1. Në përgjigje të shkresës nr. 999/1, datë 28.07.2020, të Komisionerit, Assist sh.p.k dërgoi shkresën nr. 999/3, datë 28.08.2020, nëpërmjet së cilës sqaron se kjo shoqëri ka lidhur me ankuesen G.M. një kontratë individuale pune me kohëzgjatje të pacaktuar, në datën 13.11.2017, në detyrën “contact center agent”⁶. Kontrata e punës është zgjidhur nga ana e Shoqërisë në datën 06.07.2020, në vijim të një procedure të ndjekur nga ana e Shoqërisë, në mbështetje të nenet 141, 143, 144, të Kodit të Punës.

⁵ Neni 33, pika 7, i ligjit 10 221/2010, parashikon: “Me marrjen e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t’u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 30 ditëve nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacione dhe nga çdo person ose burim tjetër”.

⁶ Referuar shprehimisht shkresës nr. nr. 999/3, datë 28.08.2020, të Assist sh.p.k. ;

Në shkresë theksohet se pretendimi i ankueses është i pabazuar. Mbështetur në nenin 13 të Kontratës Individuale të Punës të lidhur ndërmjet kësaj shoqërie dhe ankueses parashikohet shprehimisht: *“Çdo pretendim i punëdhënësit që rrjedh nga kontrata e punës duhet bërë me shkrim dhe të nënshkruhet nga ana e punëdhënësit. Punëmarrësi njuh dhe pranon se nuk mund të merret në konsideratë asnjë pretendim me gojë i bërë prej tij për këtë qëllim.”*Në këtë kuptim theksohet nga ana e shoqërisë, se çdo argument i paraqitur nga ana e ankueses për ankesa të bëra verbalisht tek supervizorët e saj dhe të paadresuara në formë të shkruar tek Punëdhënësi nuk mund të merren në konsideratë pasi janë tërësisht në kundërshtim me kontratën e lidhur midis palëve, e cila në kuptim të nenit 690, të Kodit Civil ka forcën e ligjit midis palëve.

Në vijim, Assist sh.p.k. vijon me prapësimet, në lidhje me pretendimet e ankueses G.M. Muça.

Sipas shkresës nr. 999/3, datë 28.08.2020, së Assist sh.p.k., pretendimi i ankueses se: *“të drejtat e punonjësve nuk respektohen dhe mbi ta ushtrohej vazhdimisht presion për largim nga puna nëse ndonjë prej tyre nuk punonte jashtë orarit.”*

Për sa më sipër, Assist sh.p.k. thekson faktin se asnjë punëmarrës i kësaj shoqërie nuk është larguar nga puna për refuzim të kryerjes së orëve shtesë të punës gjatë kohëzgjatjes ditore dhe javore të punës të përcaktuar në nenin 4, të Kontratës Individuale të Punës. Çdo orë punë e kryer me vullnetin dhe dëshirën e lirë të çdo punëmarrësi është paguar rregullisht me shtesat përkatëse mbi pagën orare neto sipas parashikimeve të Rregullores së Brendshme të ndërmarrjes, pjesë përbërëse e Kontratës Individuale të Punës, mbështetur kjo në dispozitat e Kodit të Punës.

Së dyti, Assit sh.p.k. hedh poshtë pretendimin e ankueses se: *“Punonjësit herë pas here penalizoheshin nga eprorët e tyre pranë kësaj shoqërie, duke mos u aprovuar lejet në datat e kërkuara nga ta.”* Në këtë kontekst, Assist sh.p.k. sqaron se lejet vjetore aprovohen sipas Rregullores së Brendshme të ndërmarrjes duke marrë parasysh nevojat e punëmarrësve, natyrën e aktivitetit dhe numrin e punëmarrësve të zënë me punë në atë aktivitet. Assit sh.p.k. ka mbi 930 punonjës të punësuar, 730 prej të cilëve janë të zënë me punë në aktivitetin e shërbimit të klientit, ku punonte edhe ankuesja.

Shërbimi i klientit punon prej orës 08:00 deri në orën 22:00 çdo ditë të vitit, për arsye operative dhe kontraktuale shërbimi është gjithmonë aktiv dhe punëmarrësit shfrytëzojnë lejen e tyre gjatë vitit disa herë jo më pak se një javë kalendarike pa ndërprerje çdo herë. Përveç

lejes vjetore, ndërmarrja i ka ardhur gjithmonë në ndihmë çdo punëmarrësi duke qenë fleksibël mbi turnet e punës dhe duke aprovuar pushime të paguara sipas nevojave të punëmarrësve. Ankuesja rezulton të ketë shfrytëzuar 27 orë pushime të paguara nga ndërmarrja mbi orët që i takonin sipas përcaktimeve të Rregullores së Brendshme të ndërmarrjes dhe Kontratës Individuale të Punës.

Së treti, Assist sh.p.k. thekson faktin se nuk qendron pretendimi i ankueses se: *“...punonjësit e Assist sh.p.k. i kanë detyruar punonjësit të nënshkruajnë një akt, nëpërmjet së cilit ata i japin Shoqërisë miratimin e tyre për të patur akses në të dhënat e tyre sensitive, përfshirë këtu orientimin seksual, bindjet fetare, politike, si dhe mbi të dhënat e llogarive bankare të të afërmeve të tyre.”*

Për sa më sipër, kjo shoqëri sqaron se në kuadër të përmbushjes së detyrimeve mbi GDPR, ka vendosur në dispozicion të të gjithë punëmarrësve dokumentin “informacion mbi përpunimin e të dhënave

C. Në vijim të procedurave hetimore, palët u njoftuan për seancë dëgjimore, e cila u zhvilluar në datën 20.10.2020, pranë Zyrës së KMD-së.

Në këtë seancë dëgjimore mori pjesë përfaqësuesi ligjor i Assist sh.p.k. dhe ankuesja G.M.. Ankuesja parashtroi edhe një herë pretendimet e saj kundër Assist sh.p.k., duke theksuar faktin se qendrimi i padrejtë dhe disfavorizues ndaj saj kishte lidhje të drejtpërdrejtë me anëtarësinë e saj në Sindikatën “Solidariteti”. Ajo vuri në dukje faktin se eprorët e saj i kishin ndaluar të shprehej apo të ankohej ndaj politikave të shoqërisë. Ankuesja i bëri me dije përfaqësuesit e KMD-së së kompania kishte marrë dijeni mbi pjesëmarrjen e saj në sindikatë në muajin mars 2019. Ajo u shpreh se pas njoftimit që ajo ka kryer, nga ana e Assist sh.p.k. nuk i është kërkuar dokumentacioni përkatës për të vërtetuar anëtarësinë e saj në Sindikatën “Solidariteti”. Ajo informoi se ka edhe persona të tjerë që janë të anëtarësuar pranë kësaj sindikate.

Gjatë mbledhjeve të punës, ankuesja u shpreh se është ankuar mbi faktin se nuk mund të paraqitet në punë në orën 8:00 të mëngjesit, në kushtet kur në turnin paraardhës ka qenë në punë deri në orën 10:00 të darkës. Një fakt i tillë sipas saj është në kundërshtim me kontratën e punës.

Problematikë tjetër e parashtruar nga ankuesja është edhe çështja e nënshkrimit të formularit që përmbante të dhëna personale, sensitive të tilla si feja, orientimi seksual, bindjet politike, etj. Ky formular u është dhënë për plotësim gjatë procesit të punës, pa iu dhënë mundësinë punonjësve të njiheshin mirë me përmbajtjen e tij. G.V. ka qenë personi me të cilin, ankuesja ka patur debat, lidhur me të dhënat që kërkoheshin. Lidhur me këtë problematikë ankuesja ka depozituar ankesë

pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe të Dhënave Personale, i cili sipas ankueses është shprehur pro saj. Ajo sqaron se nuk e ka nënshkruar asnjëherë këtë formular.

Problematikë tjetër e evidentuar nga ankuesja ka qenë edhe mosdhënia e lejes vjetore nga ana e punëdhënësit. Ankuesja sqaron se ka kërkuar një leje 2 ditore nga punëdhënësi, pasi ka patur një provim. Supervizorja ka rënë dakord dhe është shprehur se do të fliste me menaxherin F.O. Në vijim, punëdhënësi e ka konsideruar dy ditëshin e pushimit të ankueses si mungesë në punë, pasi z. F.O. nuk e ka parë të arsyeshme që ankueses t'i jepej leje. Znj. G.M. sqaron se ne vijim ka patur takim me z. F.O., me të cilin ka patur debat, në lidhje me pjesëmarrjen e saj në sindikatë. Gjithësesi, dy ditëshi i pushimit nuk i është aprovuar.

Në vijim, ankuesja ka sqaruar se ka patur mbarëvajtje të mirë në punë. Gjatë periudhës së pandemisë Covid-19, punonjësit janë pajisur me kompjuter për të punuar nga shtëpia. Shërbimi i transportit të kompjuterave dhe të internetit është paguar nga vetë punonjësit. Ankuesja tregon një episod, ku ndërsa punonte në shtëpi, i është shkëputur shërbimi i internetit dhe këtë fakt ia ka bërë të ditur supervizores së saj, e cila menjëherë i ka kërkuar të kthejë kompjuterin në punë.

E pyetur nga përfaqësuesit e Komisionerit se, cilat kanë qenë aktivitetet e kryera në ambientet e kompanisë nga ankuesja në emër të Sindikatës që ajo përfaqësonte dhe për të cilat ajo mendonte se është diskriminuar, Znj. G.M. u përgjigj se nuk ka kryer aktivitete dhe se anëtarët e tjerë të sindikatës “Solidariteti” që janë punëmarrës pranë Assist sh.p.k. e kanë mbajtur fshehtë anëtarësinë e tyre, si dhe nuk shprehen apo ankohen tek punëdhënësi, pas largimit të ankueses nga puna. Përfaqësuesit e KMD-së kërkuan informacion nga ankuesja, nëse ka patur njoftim zyrtar nga ana e Sindikatës “Solidariteti” drejtuar Assist sh.p.k., lidhur me anëtarësinë e znj. G.M. apo punonjësve të tjerë të kësaj kompanie, në këtë sindikatë.

Ankuesja u shpreh se gjatë dëgjësës së kryer nga punëdhënësi, lidhur me masën disiplinore që asaj do t'i jepej në vijim, ajo ka patur përfaqësues ligjor në këtë takim, kryetarin e Sindikatës “Solidariteti”, fakt që i është bërë i ditur edhe përfaqësuesve të punëdhënësit.

Ankuesja u shpreh gjithashtu se në muajin maj 2020 ka munguar 4 ditë në punë, pasi kompania nuk kishte kompjutera të disponueshëm për të punuar, si dhe nuk respektoheshin masat anticovid. Ankuesja u shpreh se supervizorja e saj i ka sqaruar se mund të rrinë në shtëpi dhe për këtë arsye znj. G.M. ka munguar 4 (katër) ditë në punë. E pyetur nëse shoqëria kishte një rregullore mbi bazën e së cilës kryhej organizimi i brendshëm dhe përcaktoheshin rregullat dhe procedura mbi të cilat kryhej puna, ankuesja u shpreh se Assist sh.p.k. kishte dhe zbatonte Rregulloren e Brendshme të tij.

Në vijim, përfaqësuesi ligjor i Assit sh.p.k. e mori fjalën dhe dha sqarimet përkatëse lidhur me pretendimet e ankueses G.M.. Ai sqaroi se Assist sh.p.k. ka 900 punonjës dhe e ushtron aktivitetin e tij në Itali. Kjo kompani operon prej 5 vitesh në shqipëri dhe konsiderohet një nga kompanitë më të mira të fushës. Shoqëria respekton dispozitat e Kodit të Punës, në lidhje me respektimin e të drejtave të punonjësve. Ai sqaroi se rasti i ankesës së znj. G.M. është unik dhe i veçantë. Ai sqaroi se ankuesja nuk ka bërë deklaram para shoqërisë lidhur me anëtarësinë e saj në Sindikatën “Solidaritë”, si dhe nuk ka ndërmarrë asnjë aktivitet pranë kësaj shoqërie për llogari të kësaj sindikate. Përfaqësuesi ligjor i Assist sh.p.k. vuri në dukje faktin se ankuesja pretendon se ka anëtarësi pranë kësaj sindikate që prej muajit mars 2019, ndërkohë që Sindikata është krijuar në muajin korrik 2019. Ankuesja pretendon se ka bërë ankesa pranë punëdhënësit, por nga verifikimet e kryera nuk rezultoi të ketë ankesa me shkrim nga ana e saj në adresë të Assist sh.p.k. Kjo kompani nuk ka patur dijeni që ankuesja ka qenë anëtare sindikate. Në takimin e realizuar gjatë procedimit për masë disiplinore, ankuesja është paraqitur me përfaqësues ligjor, i cili koiçidoi të ishte Kryetar i Sindikatës “Solidaritë”. Përfaqësuesi ligjor i Assist sh.p.k. sqaron se në e-mailin e dërguar nga ankuesja në adresë të shoqërisë, ku ajo kërkon të përfaqësohet nga një përfaqësues ligjor, por që ky i fundit nuk është prezantuar në cilësinë e Kryetarit të Sindikatës “Solidaritë”. Shoqëria ka marrë masen disiplinore “vërejtje me shkrim” ndaj ankueses, si pasoje e kryerjes së disa mungesave të pajustificuara në punë nga ana e saj. Ai theksoi sërish faktin se ankuesja, në asnjë rast nëpërmjet e-maileve të saj, nuk ia ka bërë të ditur punëdhënësit se është anëtare e sindikatës “Solidaritë”, sikurse edhe vetë kjo sindikatë nuk ka kryer njoftim pranë Assist sh.p.k., lidhur me anëtarësinë e ankueses në të. Marrja dijeni për herë të parë mbi këtë sindikatë ka qenë pikërisht dita në të cilën është realizuar takimi, ose dëgjesa lidhur me procedimin disiplinor të ankueses. Njëkohësisht, përfaqësuesi ligjor i shoqërisë theksoi faktin se mungesat në punë të ankueses nuk kishin të bënin me anëtarësinë e saj në këtë sindikatë, apo me aktivitetin sindikal të ankueses, por në lidhje me largësinë e banesës së saj nga puna, si dhe mbi marrjen e masave anticovid nga ana e shoqërisë. Masa disiplinore nuk është kundërshtuar nga ankuesja as pranë punëdhënësit dhe as në gjykatë. Ankuesja ka refuzuar të nënshkruante për marrjen në dorëzim të akteve dhe punëdhënësi ia ka dërguar asaj të gjitha aktet përkatëse nëpërmjet shërbimit postar. Përfaqësuesi ligjor i kompanisë u shpreh se ankuesja ka pretenduar diskriminim nga ana e Assist sh.p.k., pasi sipas saj, kjo kompani i ka ndaluar të ketë akses në godinën e saj, pas zgjidhjes së kontratës së punës me këtë kompani. Lidhur me këtë çështje, Assist sh.p.k. sqaron se ankueses i është kthyer përgjigje zyrtarisht mbi këtë çështje.

Njëkohësisht, ai u shpreh se Assist sh.p.k. nuk ka dijeni në lidhje me ankesën e znj. G.M. pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Assist sh.p.k. ka qenë subjekt kontrolli nga ky institucion, i cili është shprehur me Rekomandim ndaj tij. Shoqëria e

ka plotësuar Rekomandimin e sipërcituar. Ai sqaroi gjithashtu se Formulari ka qenë një dokument i mbështetur në Rregulloren Europiane për Trajtimin e të Dhënave Personale dhe shoqëria në asnjë rast nuk ka kërkuar të dhëna mbi orientimin seksual dhe bindjet politike. I pyetur mbi faktin se kur datonte Rekomandimi i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, duke marrë si referencë ankesën e znj. G.M. pranë këtij institucioni, përfaqësuesi ligjor u shpreh se Assist sh.p.k. nuk kishte dijeni mbi ankesën e saj pranë këtij institucioni, si dhe veprimet e kësaj shoqërie ndaj ankueses nuk kishin lidhje me depozitimin e kësaj ankese. Zgjidhja e kontratës individuale të punës me ankuesen konsiston në një tjetër objekt, që ka të bëjë me ndërhyrje në të dhënat personale të personave të tretë nga znj. G.M. Veprimet e saj kanë çenuar rëndë punëdhënësin në raport me klientin e tij. Ankuesja ka refuzuar të nënshkruajë procesverbalin e takimit që u realizua në kuadër të zgjidhjes së kontratës së punës. Ankuesja u shpreh në kundërpërgjigje të përfaqësuesit ligjor të shoqërisë, se ajo nuk mund të kishte akses tek tabulatet telefonike dhe se askush nuk mund të kishte, pa një vendim gjykate. Ajo u shpreh se punonjës të tjerë, që kishin kryer veprimet e saj, nuk ishin larguar nga puna, por thjesht u ishte dhënë vërejtje.

1. Në vijim të seancës dëgjimore, Komisioneri iu drejtua z. T. P., Kryetar i Sindikatës Kombëtare të Qendrave të Kontaktit – Solidariteti dhe znj. G.M., nëpërmjet shkresës nr. 1481, datë 29.10.2020⁷, ku kërkohej informacioni i mëposhtëm:

- Informacion mbi datën e anëtarësimit të znj. G.M. pranë Sindikatës Solidariteti.
- Muaji/viti, në të cilin znj. G.M. ka filluar të paguajë kuotizacionet në Sindikatë nëpërmjet sistemit bankar.
- Informacion nëse Sindikata Solidariteti e ka njoftuar zyrtarisht Assit sh.p.k., mbi krijimin e saj, si dhe mbi anëtarësinë e znj. G.M., apo punonjësve të tjerë të kësaj shoqërie, në këtë sindikatë.
- Informacion nëse Sindikata Solidariteti ka zhvilluar aktivitete të ndryshme me anëtarët e saj, përfshirë edhe anëtarët që janë punonjës të Assist sh.p.k. dhe ka qenë në marrëdhënie me këtë shoqëri, në kuadër të zhvillimit të këtyre aktiviteteve;
- Numri i përgjithshëm i anëtarëve të Sindikatës Solidariteti, si dhe lista emërore e tyre, duke evidentuar datën e anëtarësimit;
- Lista emërore e punonjësve të Assist sh.p.k., që janë anëtarë të Sindikatës Solidariteti;

Znj. G.M. iu kërkua të depozitonte pranë KMD-së, kopje të të gjithë pagesave/kuotizacioneve të kryera për llogari të Sindikatës Solidariteti, si dhe të gjithë provat që ajo i mendonte të nevojshme, që Komisioneri duhet t'i dispononte në kuadër të shqyrtimit të ankesës së saj.

⁷ Shkresa nr. 1481, datë 29.10.2020, e KMD-së iu dërgua për dijeni edhe Assist sh.p.k.

2. Në përgjigje të shkresës nr.1481, datë 29.10.2020, të KMD-së, z. T. P., Kryetar i Sindikatës Kombëtare të Qendrave të Kontaktit – Solidariteti dërgoi shkresën nr. 20, datë 02.11.2020, nëpërmjet së cilës informoi se:

1. *“Znj. G.M. është anëtarësuar pranë Sindikatës Solidariteti në datën 29.11.2019. Bashkëlidhur gjeni edhe formularin e anëtarësimit të plotësuar nga ajo.*

2. *Nga njohja e personit juridik të Sindikatës nga Gjykata, deri më sot ka qenë e pamundur për ne mbledhja e kuotizacioneve. Tërmeti dhe pandemia kanë pamundësuar zhvillimin normal të aktiviteteve të një sindikate të sapothemeluar. Për pasojë, Sindikata Solidariteti deri më sot nuk ka mbledhur kuotizacione nga asnjë anëtar, përfshirë kryetarin dhe strukturat drejtuese të saj, Megjithatë, në formularin e anëtarësimit të znj. G.M., kjo e fundit ka deklaruar gatishmërinë e saj për të paguar kuotizacionin e kërkuar nga Sindikata.*

3. *Në datën 13.04.2020, znj. G.M. është paraqitur pranë zyrave të kompanisë për të zhvilluar një takim me përfaqësuesit e kompanisë në shoqërinë e përfaqësuesit të saj nga Sindikata, respektivisht me kryetarin e sindikatës z. T.P. Ky takim duhet të jetë i regjistruar në procesverbalet e kompanisë.*

4. *Në aktin e themelimit të Sindikatës, i cili është i qasshëm për publikun pranë gjykatës, figurojnë emrat e anëtarëve themelues dhe anëtarëve të Bordit Drejtues të Sindikatës. Ndër të cilët janë edhe punëtorë të kompanisë Assist sh.p.k. Gjithashtu znj. G.M. ka qenë pjesëmarrëse në disa mbledhje të grupit të Assist sh.p.k. brenda Sindikatës. Për këto mbledhje znj. G.M. dhe Sindikata mund të sjellë dëshmiratë të cilët janë anëtarë dhe kanë qenë pjesëmarrës në takim.*

5. *Numri i përgjithshëm i anëtarëve të Sindikatës Solidariteti është 138 anëtarë. Lista e anëtarëve është një e dhënë sensitive, e cila nuk lidhet drejtpërsëdrejti me rastin në fjalë.*

6. *.....Politikë e Sindikatës Solidariteti është mosdeklarimi i emrave të anëtarëve pranë përfaqësuesve të kompanive duke patur parasysh faktin se kjo rrezikon punëtorët e deklaruar... Të dhëna të tilla mund t'i bëjmë të ditura vetëm në mënyrë konfidenciale para përfaqësuesve të institucionit tuaj, duke marrë si garanci mospraraqitjen e këtyre të dhënave tek përfaqësuesit e kompanisë.....”*

- Në përgjigje të shkresës nr.1481, datë 29.10.2020, të KMD-së, znj. G.M. dërgoi shkresën nr. 1519/1, datë 04.11.2020, nëpërmjet së cilës fillimisht informon se bashkëlidhur shkresës së saj ndodhen dokumentet që disponon lidhur me anëtarësimin e saj në Sindikatën Solidariteti, si

dhe kopje të vendimit të marrë nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, i cili daton në 24.05.2019, lidhur me ankesat që ka bërë në këtë institucion për shkak të presionit që kompania Assist sh.p.k. ka ushtruar ndaj saj, duke kërkuar të nënshkruajë formularin në bazë të së cilit kjo shoqëri do të kishte ë drejtë të përdorte të dhënat e saj sensitive, sikurse edhe të të gjithë punonjësve të tjerë të kësaj shoqërie.

Në seancën dëgjimore të zhvilluar pranë KMD-së, ankueses i është kërkuar të depozitojë kopje të e-maileve drejtuar Zyrës së Burimeve Njerëzore. Lidhur me pakënaqësitë e ankueses lidhur me kushtet e punës, e më konkretisht lidhur me mosrespektimin e orareve të përcaktuara në bazë të kontratës së punës, ankuesja sqaron se provë për këtë mund të përbëjë dëshmia e secilit prej punonjesve dhe kolegëve të saj, pasi ajo e ka shprehur hapur shqetësimin e saj edhe pas ankesave të bëra në grupin e punës, pasi mjeti i tyre i komunikimit ka qenë aplikimi WhatsApp. Ankuesja sqaron se takimi i saj me përfaqësuesit e Zyrës së Burimeve Njerëzore, lidhur me shqetësimin e saj, është zhvilluar në zyrën e menaxherit G. V., i cili ka qenë pasiv në diskutim, por nga përfaqësuesit e Burimeve Njerëzore të shoqërisë nuk i është ofruar zgjidhje lidhur me shqetësimin e saj dhe të kolegëve të saj.

Ankuesja shprehet se ka kolegë të tjerë, të saj, që edhe pse kanë bërë më shumë mungesa se ajo, gjatë periudhës së Pandemisë Covid -12, ndaj tyre nuk është marrë masë disiplinore. Njëkohësisht, ajo informon se kjo kompani nuk ka zbatuar rregullat e distancimit dhe mbrojtjes nga përhapja e infektimit nga virusi Covid-12. Inspektoriati i Punës ka kryer 2 herë inspektim pranë kësaj shoqërie, dhe nuk ka konstatuar shkelje pasi vetë Inspektoriati ka lajmëruar paraprakisht Assit sh.p.k. mbi kontrollet dhe personat përgjegjës të shoqërisë shpërndanin maska e doreza për punonjësit.

Ankuesja informon gjithashtu se diskriminimi ndaj saj ka vazhduar edhe më tej duke mos e bërë pjesë të grupeve të punës, pa asistencë në sallë e deri në mohimin e aksesit në ambientin e punës (pas zgjidhjes së kontratës së punës). Znj. G.M. thekson faktin se Assist sh.p.k. i ka mohuar të njihet me shkakun e vërtetë të largimit nga puna. Ajo ka kërkuar të disponojë një kopje të e-mailit nëpërmjet së cilit Vodafone ITALIA kërkonte inspektim, lidhur me kredencialet e saj, por ky informacion nuk i është vënë në dispozicion. Ajo thekson faktin se ajo dhe kolegët e saj kanë bërë rimbursime edhe të padokumentuara, por që bëheshin me dijeni të eprorëve të tyre për të blerë votat e klientëve. Ajo shprehet se bashkëlidhur shkresës së saj ka depozituar foto, mbi bazën e së cilave, dokumentohet se rimbursimi minimal prej 2.98 euro, që kompania përdori si justifikim dhe shkak për largimin e saj nga puna është i dokumentuar nga sistemet e shoqërisë.

3. Në vijim, në adresë të Komisionerit, Assist sh.p.k. dërgoi shkresën nr. 1467, datë 28.10.2020, sipas së cilës jepen sqarimet përkatëse sipas problematikave të mëposhtëme:

- **Lidhur me Vendimin e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.**

Në Rekomandimin nr. 27, datë 24.05.2020, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDIMDHP) nuk evidentohet emri i personave ankues dhe sidomos emri i znj. G.M., ndaj edhe shoqëria Assist sh.p.k. sikurse e ka deklaruar gjatë seancës dëgjimore i qendron argumentit të saj se nuk ka qenë asnjëherë në dijeni të faktit që ankuesja ka depozituar ankim pranë këtij institucioni. Njëkohësisht, shoqëria Assist sh.p.k. i ka konsideruar dhe trajtuar problematikën e trajtuara në Rekomandimin e KDIMDHP, jo në kuadrin e shkeljes së të drejtave të punëmarrësve të saj, por në kuadrin e implementimit sa më të mirë të Normativës për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Rregullores Europiane nr. 16/679 dhe ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”. Shoqëria Assist sh.p.k është certifikuar për standardin e sigurisë së informacionit ISO/IEC 27001:2013, në muajin Korrik 2019, certifikim, i cili është rinovuar në muajin korrik 2020.

Bashkëlidhur shkresës është depozituar në cilësinë e provës Deklarata e Vlerësimit Vjetor ISO/IEC, datë 20.07.2020. Në shkresën e Assist sh.p.k. theksohet fakti se kjo shoqëri ndodhet në regjistrin e kontrolluesve të certifikuar, të publikuar në faqen zyrtare të KDIMDHP-së për të drejtën e informimit. Në vendin tonë, vetëm 4 shoqëri e kanë këtë lloj certifikimi, fakt që e vendos Assist sh.p.k. në pararojën e shoqërive për trajtimin e të dhënave personale në Shqipëri, për trajtimin e të dhënave personale me standarde të certifikuara ndërkombëtare dhe të njohura edhe nga KDIMDHP.

- **Lidhur me praktikën e dhënies së masës disiplinore ndaj znj. G.M..**

Në shkresën e Assist sh.p.k. theksohet fakti se masa disiplinore “*vërejtje me shkrim*” është marrë ndaj ankueses për shkak të mungesave të paarsyeshme në punë, në datat 30.03.2020, 01.04.2020, 02.04.2020, 03.04.2020 dhe 06.04.2020. Ankuesja nuk e ka kundërshtuar masën disiplinore as pranë punëdhënësit dhe as në gjykatë.

Në cilësinë e provës, Assist sh.p.k. ka depozituar pranë KMD-së, evidencën e sistemit të shoqërisë në lidhje me praninë në punë, të regjistruar në sistemet e brendshme të ndërmarrjes për muajt mars - prill 2020, muaj, kur ankuesja ka patur mungesa në punë dhe ka marrë vërejtje me shkrim.

Njëkohësisht, shoqëria ka depozituar edhe formularin e dorëzimit të kredencialeve për aksesin në sistemin Archimede (sistemi që regjistron praninë në punë).

Në shkresën e Assist sh.p.k. theksohet fakti se për të vërtetuar që ndaj të gjithë punonjësve është mbajtur qendrim i barabartë për sa i përket mungesave në punë, ka përcjellë pranë KMD-së, praktikat e procedimit disiplinor për disa punëmarrës të tjerë që kanë kryer mungesa të paarsyeshme. Për disa prej tyre është marrë edhe masa disiplinore e largimit nga puna.

- Lidhur me shkakun e zgjidhjes së marrëdhënieve të punës me znj. G.M..

Në shkresën e Assist sh.p.k. vihet në dukje fakti se sikurse është cilësuar në seancë dëgjimore, arsyeja për të cilën është zgjidhur kontrata e punës me ankuesen ka lidhje me *“sjelljen e punëmarrëses”* dhe konkretisht me *“shkelje të normativës për trajtimin e të dhënave personale (verifikim tabulatesh të paautorizuara nga Klienti)”*, si dhe me *“rimbursime të kryera jashtë procedure”* të kryera nga ana e saj dhe të verifikuara në operacionet me anomali të kryera përmes aplikacioneve Vodafone, shkelje këto të cilat janë në kundërshtim me (1) rregullat e ndërmarrjes dhe procedurat operative në fuqi; (2) janë në konflikt me interesat e punëdhënësit; (3) çenojnë aktivitetet e punëdhënësit dhe të klientit të tij Vodafone; (4) çenojnë direkt imazhin e punëdhënësit dhe të klientit të tij Vodafone dhe vënë në vështirësi marrëdhënien e shoqërisë Assist me klientin Vodafone duke e ekspozuar jo vetëm me pagimin e penaliteteve të rënda, porse edhe deri në zgjidhjen e kontratës. Në shkresë sqarohet se ankuesja ka shkelur nenet 2.2, 4.2 b), e), h), dhe 7.4 d) të Rregullores së Brendshme të Ndërmarrjes.

Assist sh.p.k. informon gjithashtu se ankuesja nuk e ka bërë objekt shqyrtimi gjyqësor çështjen e zgjidhjes së kontratës së punës. Në cilësi prove, kjo shoqëri ka depozituar pranë KMD-së Vërtetimin e datës 22.10.2020, të lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku pasqyrohen çështjet gjyqësore aktive të shoqërisë Assist sh.p.k. pranë kësaj gjykate.

Në vijim të provave të paraqitura pranë KMD-së, Assist sh.p.k. thekson faktin se për të hedhur dritë më tej mbi shkakun e largimit nga puna të ankueses, bashkëlidhur kësaj shkrese ka depozituar foto nga profili i FB së znj. G.M., ku rezulton se z. A. A. është person ngushtësisht i njohur prej ish-punëmarrëses G.M.. Numri Vodafone në të cilin znj. G.M. ka kryer rimbushje dhe ka parë *“dettaglio traffico”* pa kontakt telefonik rezulton të jetë i regjistruar në emër të z. A. A. Ky fakt provon faktin se jo vetëm që kemi të bëjmë me rimbursime të paautorizuara dhe verifikim tabulatesh të paautorizuara nga Klienti, në kuadër të marrëdhënies së punës, porse edhe gjatë procesverbalit të takimit të datës 04.05.2020, G.M. ka fshehur njohjen me z. A.A. (i cili në bazë të provave rezulton të jetë i dashuri apo i fejuari i saj), duke u justifikuar me faktin se kërkesa i kishte

ardhur nga një numër telefoni tjetër apo se kërkesa mund t'i ketë ardhur nga kolegu ngjitur. Në këtë kontekst, shoqëria Assist sh.p.k. vë në dukje faktin se është mëse evidente shkelja e kryer nga ankuesja.

Ndër të tjera, Assist sh.p.k. ka theksuar faktin se ka depozituar fakte dhe prova që vërtetojnë se edhe punonjës të tjerë që kanë kryer të njëjtën shkelje, kanë patur të njëjtin trajtim, sikurse ankuesja, duke iu zgjidhur kontrata e punës. Në shkresë sqarohet se shoqëria është në proces gjyqësor për zgjidhje të marrëdhënieve të punës, për të njëjtin shkak, me z. A. T., z. L. K. dhe z. R.C.

Njëkohësisht, Assist sh.p.k. ka paraqitur edhe praktikën e dorëheqjes së znj. Sh. A., një ish-punëmarrëse tjetër e shoqërisë, e cila përballë faktit të pamohueshëm, që kishte parë në mënyrë të paautorizuar tabulatet e ish-bashkëshortit të motrës së saj, ka dhënë dorëheqjen nga puna. Përveç kësaj, Assist sh.p.k. ka depozituar në cilësi prove praktikën e zgjidhjes së kontratës së punës së një punëmarrëseje tjetër, znj. V. T., e cila ka kryer të njëjtën shkelje sikurse ankuesja.

- Lidhur me pretendimin që ankuesja është anëtare e një grupi të veçantë “sindikatë”.

Assist sh.p.k. sqaron se sikurse ka deklaruar në komunikimin zyrtar me KMD-në, por edhe gjatë seancës dëgjimore, ankuesja ka investuar Komisionerin me këtë ankesë, pa paraqitur kuotizacionet e paguara për llogari të sindikatës përmes sistemit bankar, të cilat përbëjnë provë të rëndësishme lidhur me vlefshmërinë e shkakut të diskriminimit. Sipas Assist sh.p.k., ankuesja nuk ka depozituar në cilësi prove as edhe një vërtetim noterial mbi datën, në të cilën ajo pretendon se është anëtarësuar në sindikatë. Në shkresë theksohet fakti, se ankuesja ka pretenduar që është anëtare e sindikatës, që prej muajit mars 2018, kohë në të cilën sindikata, ku ajo pretendon se aderon nuk ekzistonte.

Assist sh.p.k. thekson faktin se nuk ekziston asnjë sindikatë, që të ketë bërë kërkesë për t'u njohur si e tillë, si dhe nuk ka asnjë punëmarrës të saj që të jetë anëtar sindikate dhe të ketë kërkuar që të njihet si i tillë, përfshirë ankuesen. Kjo shoqëri shprehet se praktika që ndiqet në raste të tilla është komunikimi me shkrim me punëdhënësin dhe autorizimi që i jepet këtij të fundit për mbajtjen e kuotës sindakale dhe derdhjen e saj në favor të sindikatës, në referencë të nenit 117/2 të Kodit të Punës. Shoqëria sqaron se një gjë e tillë nuk ka ndodhur.

Bashkëlidhur shkresës së Assist sh.p.k. janë dërguar, aktet e mëposhtëme:

- Rekomandimi nr. 27, datë 24.05.2019 për kontrolluesin “Assist sh.p.k.” i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, përcjellë nëpërmjet shkresës nr. 444/1 Prot., datë 24.05.2019.

- Deklaratë e Vlerësimit Vjetor ISO/IEC 27001:2013, datë 20.07.2020;
- Prania në punë e regjistruar në sistemet e brendshme të Ndërmarrjes për muajin mars, prill 2020, muaj kur ka pasur mungesa në punë dhe ka marrë vërejtje me shkrim, ashtu si edhe formulari i dorëzimit të kredencialeve për aksesin në sistemin Archimede (sistemi që regjistron praninë në punë).
- Foto të marra nga Platforma FB në faqen e ankueses Gersiona G.M., ku rezulton se z. A.A. është një person ngushtësisht i njohur prej ish-punëmarrëses. Numri vodafone në të cilin ankuesja ka kryer rimbushje dhe ka parë “dettaglio traffico” pa kontakt telefonik rezulton të jetë i regjistruar në emër të z. A. A.;
- Vërtetim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë datë 22.10.2020;
- Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 1197, datë 21.02.2020, Nr. 2006 i Regj.Them., datë 12.04.2019, me palë paditëse z. R.C. dhe palë të paditur Assist sh.p.k.;
- Praktika e zgjidhjes së marrëdhënies së punës me z. R.C.;
- Praktika e zgjidhjes së marrëdhënies së punës me z. A. T.;
- Akt ekspertimi gjykate në lidhje me evidentimin e shkeljeve të z. A.T.;
- Praktika e zgjidhjes së marrëdhënies së punës me z. L.K.;
- Letër dorëheqje Sh. A., pasi ka pranuar me shkrim se ka parë disa herë “dettaglio traffico” të ish-bashkëshortit të së motrës;
- Praktika e zgjidhjes së marrëdhënies së punës me znj. V.T.;
- Praktika e masave disiplinore për znj. R.D.;
- Praktika e masave disiplinore për z. K.S. dhe z.M.S, znj. L.G., E.K., J.S., G.Sh.;
- Praktika e masave disiplinore dhe largimit nga puna të z. R.B dhe z. S.B.;
- Praktika e largimit nga puna për znj. A.S., K.Q., znj. A.G., z. A.S., z. K.B.;
- Masa disiplinore dhe mbyllje kontrate pune për periudhën mars-qershor 2020. Masa disiplinore për mungesa të pajustificuara dhe ndërprerje marrëdhënie pune për mungesa të pajustificuara, etj.

D. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

Mbështetur në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri vlerëson se:

1. Lidhur me trajtimin e padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë të ankueses.

Mbështetur në Kontratën Individuale të Punës, me afat të pacaktuar, datë 13.11.2017, të lidhur ndërmjet Assist sh.p.k. dhe Znj. G.M. rezulton se kjo e fundit ka punuar pranë kësaj shoqërie në pozicionin e punës “agjente” në Qendrën e Kontakti/Assist sh.p.k.

Referuar Formularit të Anëtarësimit nr. 58, datë 29.11.2019, si dhe Vërtetimit nr. 14 Prot., datë 29.05.2020, të lëshuar nga Sindikata Kombëtare e Qendrave të Kontaktit - Solidariteti rezulton se ankuesja është anëtare e kësaj sindikate prej datës 29.11.2019. Sindikata “Solidariteti” është njohur si e tillë nëpërmjet Vendimit nr. 12, datë 15.07.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Ankuesja pretendon se është diskriminuar nga ana e Assist sh.p.k. për shkak të përkatësisë në një grup të veçantë, pasi ajo është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë, disfavorizues e të pabarabartë nga ana e punëdhënësit të saj, si pasojë e të qenurit anëtare e Sindikatës Solidariteti.

Gjatë verifikimit të provave të depozituara nga të dyja palët në proces, Komisioneri ka konstatuar se disa prej pretendimeve të znj. G.M. për trajtim diskriminues nga ana e punëdhënësit datojnë para datës së aderimit të saj në Sindikatën Solidariteti. Në këtë kontekst, duke patur parasysh shkakun e diskriminimit, Komisioneri ka trajtuar vetëm ato pretendime, që datojnë nga 29.11.2019⁸ e në vijim.

1. Dhënia e masës disiplinore “vërejtje me shkrim” për ankuesen G.M..

Ankuesja pretendon se nuk ka shkuar disa ditë në punë, pasi Assist sh.p.k. nuk i ka siguruar kompjuter për të punuar dhe si dhe kjo shoqëri nuk ka respektuar rregullat anticovid⁹. Shoqëria ka theksuar faktin se gjatë muajve mars-prill 2020, që përkohë me fillimin e Pandemisë Covid-19, janë marrë të gjitha masat e nevojshme për mos infektimin e punonjësve, ku disa prej tyre punonin nga shtëpia, ndërkohë që pjesa tjetër punonin në ambientet e punës duke respektuar largësinë 1.5-2 m prej njëri tjerit, si dhe ato të higjenes,

⁸ Data 20.11.2019 është data e anëtarësimit të ankueses pranë Sindikatës Kombëtare të Qendrave të Kontaktit – Solidariteti;

⁹ Pretendimi i ankueses se ka kërkuar 2 ditë pushim nga puna pasi ka patur një provim për të dhënë, i përket muajit shkurt 2020. Në këtë kontekst, një fakt i tillë nuk ka lidhje me masën disiplinore të dhënë ndaj saj, si dhe është ngjarje që ka ndodhur para anëtarësimit të saj në Sindikatën “Solidariteti”;

që konsistonin në vendosje në dispozicion të punëmarrësve maska të personalizuar, dezinfektues dhe dezinfektim të ambienteve të punës. Për sa më sipër, mbi bazën e provave të administruara nga të dyja palët, Komisioneri gjykon se nuk ekziston asnjë akt kontrolli nga institucionet kompetente që të vërtetojë të kundërtën e asaj që ka argumentuar Assist sh.p.k.

Sipas evidencave të Assist sh.p.k, që konsistojnë në printime të sistemit Archimede rezulton se znj. G.M. ka kryer 6 mungesa për muajin mars 2020 dhe 4 mungesa për muajin prill 2020. Assist sh.p.k. thekson faktin se këto mungesa janë të pajustificuara, pasi ankuesja ka munguar pa marrë leje nga eprorët e saj, si dhe raportimi lidhur me mungesat e kryera në punë nga ana e saj dhe fillimi i procedurës për dhënie mase disiplinore është kryer nga supervizori i saj, z. F.O. Sipas këtij raportimi, ankuesja ka shkelur nenet 7.2(f) dhe 7.2(g) të Rregullores së Shoqërisë, duke kryer **6 mungesa të pajustificuara për muajin mars 2020 dhe 4 mungesa sërish të pajustificuara për muajin prill 2020.**

Për sa më sipër, vlen të përmendet fakti se Assist sh.p.k. funksionon në bazë të rregullave të përcaktuara në Kodin e Punës, sikurse edhe në Rregulloren e Ndërmarrjes, përditësuar në datën 11.08.2016. Në pikën 2.2, të kësaj Rregulloreje parashikohet se: *“Punëmarrësi ka detyrimin, gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij, të ndjekë në mënyrë rigorozë rregullat e ndërmarrjes dhe procedurat operative në fuqi”*.

Në pikat 1.4 dhe 1.5 të Rregullores së sipërcituar parashikohet shprehimisht: *“1.4 Çdo shkelje e dispozitave të kontratës së punës dhe të kësaj rregulloreje do të sjellë aplikimin, për punëmarrësin përgjegjës, të një sanksioni siç përcaktohet në përmbajtjen dhe sipas formave të procedurës disiplinore që përcaktohet më poshtë”*; *“1.5 Përcaktimi i një shkeljeje duhet të bëhet në bazë të kriterëve të sakta dhe objektive që i lejojnë punëmarrësit të vihet në dijeni të plotë të fakteve që i atribuohen. Në të njëjtën mënyrë, çdo masë disiplinore duhet të jetë në përputhje me parimet e transparencës, rastit konkret dhe objektivitetit”*.

Në pikën 6.1 të kësaj rregulloreje parashikohen masat disiplinore, të cilat janë:

- a) Vërejtje me gojë ose me shkrim;
- b) Pezullimin e marrëdhënies së punës deri në 3 (tre) ditë. Ditët e pezullimit nuk do të paguhen;
- c) Transferim në një vend pune dhe/ose dhënia e detyrave më pak të kualifikuara dhe si pasojë trajtim ekonomik sipas kualifikimit të ri për një periudhë deri në 2 (dy) muaj;
- d) Ndërprerje e marrëdhënies së punë/largim nga puna;

Njëkohësisht, në pikën 7, të kësaj Rregulloreje kategorizohen, përcaktohen dhe përshkruhen me hollësi, llojet e shkeljeve të kryera nga punëmarrësi. Shkeljet kategorizohen në: shkelje të lehta, të rënda dhe shumë të rënda. Për shkeljet e rënda dhe shumë të rënda janë dhënë edhe rastet kur shkelje të caktuara të punëmarrësit mund të cilësohen të tilla. Sipas pikës 7.5 të Rregullores, punëdhënësi kryen vlerësimin e rëndësisë së faktit që i kontestohet punëmarrësit dhe përsëritjes së mundshme të këtij fakti. Si rrjedhojë, ai vendos për zbatimin e masës disiplinore më të përshtatshme midis atyre që parashikohen në këtë rregullore duke konsideruar masën e mospërmbyshjes, neglizhencës dhe rëndësinë e shkeljes, përgjegjësitë lidhur me pozicionin e punës së punëmarrësit, shkallën e rrezikshmërisë, apo dëmit të shkaktuar, si dhe ekzistencën e rrethanave rënduese apo lehtësuese.

Nëpërmjet shkresës së datës 07.04.2020, të Assist sh.p.k., ankuesja G.M. është njoftuar për fillimin e procedurës për dhënie mase disiplinore. Referuar shkresës së sipërpërmendur citohet: *“Bazuar në kontratën e punës së lidhur me ju si dhe rregulloren e Ndërmarrjes, ndaj jush ka nisur procedurë disiplinore për shkeljen e detyrimeve të përcaktuara në nenet 7.2 (f) dhe 7.2(g) të Rregullores. Procedura disiplinore bazohet në nenet 7.2 (f), 7.2 (g) dhe (6 deri 9) të rregullores. Ndërmarrja ju bën të ditur se kundrejt jush është nisur një procedurë disiplinore pas raportimit të bërë nga Business Supervisor juaj F.O. pasi keni shkelur nenet 7.2 (f) dhe 7.2 (g) të Rregullores. Për muajin Mars 2020 ju keni bërë 6 mungesa dt. 24/03-25/03-27-03-28/03-29/03-30/03 të pajustificuara. Për muajin prill 2020 ju keni bërë 4 mungesa, dt 01/04-02/04-03/04-06/04 të pajustificuara. Kjo sjellje aspak profesionale nga ana juaj ju bën përgjegjëse për shkelje të neneve 7.2 (f) e 7.2 (g) të Rregullores së nënshkruar nga ju. Në këtë aspekt, ju njoftojmë se në datën 09.04.2020, Komisioni disiplinor i ndërmarrjes i përbërë nga Business Supervisor F.O., përfaqësuesit e burimeve njerëzore R.K., O.Gj. do të vendosë në lidhje me këtë shkelje. Masa disiplinore e propozuar ndaj jush bazuar në nenin 6.1(a) të Rregullores është “vërejtje me shkrim”, Marrja e vendimit do të bëhet në datën 13.04.2020 në orën 10:00. Jeni e lutur të merrni pjesë në takim dhe të parashtroni pretendimet tuaja. Mungesa juaj pa shkak dhe /ose mungesa e nënshkrimit të këtij njoftimi nuk e pezullon procedurën.”*

Në nenin 7.2 (f) dhe 7.2 (g) të Rregullores së ndërmarrjes parashikohet shprehimisht:

“7.2 Janë shkelje shumë të rënda, por pa u kufizuar në to:

.....

f)Mungesa pa arsye në vendin e punës dhe moskryerja e detyrave;

g)braktisja pa shkak dhe e paautorizuar e vendit të punës dhe/ose mungesa pa arsye në punë për 2 ditë rresht.”

Shkresa e sipërcituar rezulton e panënshkruar nga ankuesja. Referuar procesverbalit të mbajtur nga O.Gj., R.K. dhe F.O. rezulton se në datën 07.04.2020, pasi ankuseses i është dhënë shkresa “Njoftim për masë disiplinore” dhe ka marrë dijeni mbi përmbajtjen e saj, ka refuzuar ta nënshkruajë atë. Sipas këtij procesverbali, një kopje e këtij njoftimi është bërë pjesë e dosjes personale të znj. G.M., ndërkohë që kopja tjetër do t’i dërgohej me postë dhe e-mail¹⁰ sipas adresës që i ka komunikuar shoqërisë.

Referuar e-mailit të datës 07.04.2020, të dërguar nga ankuesja në adresë znj. R.K. punonjëse e burimeve njerëzore pranë Assist sh.p.k. rezulton se znj. G.M. e ka marrë njoftimin dhe kërkon informacion nëse i lejohet të marrë dikë që ta përfaqësojë nga ana ligjore. Në këtë e-mail, ankuesja vë në dukje faktin se data 13.04.2020 është ditë feste. Në datën 09.04.2020, znj. R.K. i kthen përgjigje që mund të paraqitet në takim me përfaqësuesin e saj ligjor, sikurse i ofrohet edhe mundësia për spostim të takimit në datën 14.04.2020. Në vijim, po në të njëjtën datë, ankuesja kthen përgjigje, duke konfirmuar takimin në datën 13.04.2020, në orën e caktuar, duke theksuar faktin se do të paraqitet edhe pse është ditë feste.

Në vijim, të takimit të zhvilluar në datën 13.04.2020¹¹, Assist sh.p.k. merr Vendimin e datës 14.04.2020 për dhënie masë disiplinore. Sipas këtij vendimi, ankuseses i jepet masa disiplinore “*vërejtje me shkrim*”.

Për sa më sipër, mbështetur në pikën 3.1 të Rregullores së Ndërmarrjes parashikohet: “*Punëmarrësi ka detyrimin që të respektojë në mënyrë rigorozë orarin e vendosur për fillimin dhe përfundimin e turnit të punës.*” Në pikën 3.3. të saj përcaktohet: “*Ditët e pushimit dhe lejet duhet të bëhen në marrëveshje me ndërmarrjen...*”. Njëkohësisht në pikat c) e d) të pikës 4.3, të kësaj Rregulloreje, ku parashikohen detyrimet e punëmarrësit, përcaktohet shprehimisht: “*c) të respektojë orarin e punës dhe turnet e punës; të përmbushë formalitetet e parashikuara për marrjen e mungesave dhe të mos largohet nga vendi i punës pa autorizimin e punëdhënësit, i përfaqësuar nga personi përgjegjës*”; “*d) të mos largohet nga vendi i punës me përjashtim kur largohet për shkaqe të ligjshme dhe të njoftojë për mungesa të mundshme në vendin e punës përpara fillimit të punës ditore*”. Për sa më sipër, rezulton se ankuesja ka

¹⁰ Referuar e-mailit të datës 07.04.2020, të Assist sh.p.k. drejtuar ankuseses në adresën e saj të e-mailit.

¹¹ Assist sh.p.k. ka sqaruar se gjatë takimit të datës 13.04.2019, nuk është mbajtur procesverbal takimi. Edhe ankuesja nuk ka depozituar në cilësi prove asnjë procesverbal të takimit të datës së sipërcituar;

marrë ditë pushimi pa konfirmim të eprorëve të saj, pasi nuk rezulton të ketë asnjë dokument zyrtar në bazë të së cilit të rezultojë se supervizorja e ankueses znj. A. A. të jetë shprehur se prezenca në punë nuk është e detyrueshme.

Mbështetur në dokumentacionin e depozituar nga palët rezulton se znj. G.M. nuk e ka kundërshtuar masën disiplinore pranë punëdhënësit dhe as në gjykatë¹², si dhe Assist sh.p.k. ka zbatuar procedurat ligjore lidhur me dhënien e masës disiplinore, mbështetur në dispozitat përkatëse ligjore.

Njëkohësisht, Assist sh.p.k. ka depozituar në cilësi prove praktika të tjera masash disiplinore apo largime nga puna, për raste analoge të punonjësve të tjerë të kësaj shoqërie që kanë kryer mungesa të paarsyeshme në punë. Referuar dokumentacionit të dërguar rezulton se edhe L.K., R.D., K.S., M.S. R.M., L.G, J.S, G.Sh. dhe E.K. kanë marrë masa disiplinore si pasojë e kryerjes së mungesave të paarsyeshme në punë.

Në interpretim të nenit 7, pika 1, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, rezulton se ankuesja nuk është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë, disfavorizues e të pabarabartë nga ana e Assist sh.p.k.

Për sa më sipër, në interpretim të nenit 7, pika 1, të LMD, Komisioneri gjykon se ankuesi nuk është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë, disfavorizues e të pabarabartë.

Në mungesë të trajtimit të padrejtë, disfavorizues e të pabarabartë, nuk ka diskriminim për shkakun e pretenduar në ankesë.

2. Zgjidhja e kontratës së punës me ankuesen G.M.

Nëpërmjet shkresës së datës 30.04.2020, Assist sh.p.k. i është drejtuar znj. G.M., ku citohet: *“Me anë të kësaj letre, në bazë të nenit 141, 143, 144, të Kodit të Punës, ju njoftojmë se shoqëria Assist sh.p.k. dëshiron të zgjidhë Kontratën e Punës së lidhur me ju. Për këtë qëllim, ju ftojme të paraqiteni për bisedime më datë 04.05.2020, ora 10:00, pranë zyrës së shoqërisë....”*.

¹² Referuar vërtetimit të datës 22.10.2020, të lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku pasqyrohen çështjet gjyqësore aktive të shoqërisë Assist sh.p.k. pranë kësaj gjykate.

Në datën 04.05.2020, ndërmjet punëdhënësit Assist sh.p.k dhe punëmarrëses G.M. është zhvilluar takim lidhur me marrëdhëniet e punës. Referuar procesverbalit të takimit rezulton se arsyeja e zgjidhjes së kontratës së punës lidhet me “*sjelljen e punëmarrëses*” dhe më konkretisht ka të bëjë me shkelje të neneve 2.2., 4.2 b), e), h) e 7.4 d), të Rregullores së Ndërmarrjes nga ana e punëmarrëses. Në këtë procesverbal citohet: “*Pas verifikimeve të kryera, janë gjetur shkelje të normativës për trajtimin e të dhënave personale (verifikim tabulatesh të paautorizuara nga klienti) si dhe gjetëm rimbursim jashtë procedurës së bërë nga kredencialet ZZGMUIB e identifikuar në sistemet Vodafone si G.M. Në vijim të një komunikimi me e-mail nga Security Vodafone, Shoqërisë i është kërkuar të kryente një seri kontrollesh mbi operacionet me anomali të kryera përmes aplikacioneve Vodafone. Kontrollat zbuluan një anomali në numrin e klientit Vodafone në emrin e z. A. A. me përdoruesin e vërtetë z. G. A. Punëmarrësi G.M. i identifikuar në sistemet Vodafone me login ZZGMUIB, më 06.03.2020 në orën 16:36:40 brenda turnit (Ndërrimi 14:00 – 20:30) ka shfaqur përmbledhjen e thirrjeve të numrit _____. Afishimi i përmbledhjes së thirrjes nuk është i justifikuar pasi nuk ka asnjë kontakt telefonik të bërë nga klienti rreth 190 dhe nuk ka asnjë shënim nga ana juaj. Shfaqja e përmbledhjes së thirrjes pa autorizimin e klientit është një shkelje serioze e të dhënave personale të klientit. Përveç sa më sipër, në lidhje me numrin e mësipërm, janë verifikuar edhe 2 rimbursime në kundërshtim me procedurat Vodafone, të bëra në datën 10.01.2020 nga punëmarrësja G.M., e para në shumën 1 euro në orën 14:39:09 dhe e dyta në shumën 1.98 euro në orën 14:41:20, Përveç që janë të dyja rimbursime jashtë procedurës, nuk ka kontakt telefonik nga klienti”.*

Në mbështetje të fakteve të sipërpërmendura, Assit sh.p.k. ka dërguar pranë KMD-së në cilësi prove e-mailin e znj. F.S. (Assist sh.p.k.), të datës 14.04.2020, i cili i është dërguar z. G.V., z. A.S. dhe z. F.O., ku i informon në vijim të emailit të dërguar nga znj. L.V, e Vodafon Italy, i së njëjtës datë, ku citohet: “*Dokument i ri verifikimi për në...Janë sinjalizime në hyrjen dhe verifikimin e telefonatave, aktivizime ofertash, rimbushje dhe rimbursime nga sistemi Mercurio në sitin e Tiranës në periudhën janar-shkurt-mars 2020. Pwd hyrëse është prill 2020....*”. Njëkohësisht, kjo shoqëri ka depozituar në cilësi prove edhe Raportin e datës 30.04.2020, ku citohet: “*Pas auditimeve të kryera mbi korrektësinë e rimbursimeve, u evidentuan në numrin _____ nën emrin e z. A. A. me përdorues të kartës Sim, z. G. A., rimbursime jashtë procedurës të kryera nga përdoruesi ZZGMUIB, e identifikuar në sistemet Vodafone Italia si G.M.: Ekzaktësisht, dy rimbursime janë bërë në 10/01/2020 nga përdoruesja G.M., e para me shumën 1 euro në orën 14:39:09 dhe e dyta me shumën 1.98 euro në orën 14:41:20. Përveç faktit që të dyja rimbursimet janë jashtë procedurës, nuk ka asnjë kontakt telefonik nga klienti me numrin _____. Për të njëjtin numër me 14 prill 2020*

Security Vodafone raportoi “Anomali” në gjenerimin e tabulateve, edhe kjo e kryer nga G.M. G.M. e identifikuar në sistemet Vodafone me emrin identifikues ZZGMUIB; Në të dyja rastet nuk ka asnjë kontakt telefonik të bërë nga klienti drejt 190 (shërbimit të klientit). Janë të gjitha dyshimet që përdoruesi ka mbikqyrur numrin e klientit pa qenë ai në dijeni, duke cënuar privatësinë e tij”.

Assist sh.p.k. ka dërguar në cilësi prove në mënyrë skematike se si funksionon puna e operatorëve që punojnë për këtë shoqëri dhe mënyra se si janë pikasur shkeljet e kryera nga ankuesja nga ana e Vodafone Italia.

Për sa më sipër, rezulton se veprimet e ankueses bien ndesh me pikat vijuese të Rregullores së Ndërmarrjes:

Pika 2.2 e Rregullores, ku parashikohet: *“Punëmarrësi ka detyrimin, gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij, të ndjekë në mënyrë rigorozë rregullat e ndërmarrjes dhe procedurat operative në fuqi.”* Pika 4.2 e Rregullores parashikon: *“Punëmarrësi është i detyruar të mbajë dhe të ruajë një sjellje në përputhje me parimin e besimit drejt Punëdhënësit. Në veçanti është i detyruar të:*

.....

e) mos kryejë, për asnjë shkak, veprime që mund të cënojnë aktivitetet e Punëdhënësit apo të klientëve të tij.

.....

h) të mos kryejë asnjë veprim, i cili mund të cënojë, direkt apo indirekt, imazhin e Punëdhënësit apo të klientëve të tij;

Pika 7.4 e Rregullores parashikon gjithashtu: *“Në çdo rast, përbën shkak të shprehur për ndërprerjen e marrëdhënies së punës:*

e) Shkelje e detyrimeve që përcaktohen në nenin e mësipërm;

Znj. G.M. ka parashtruar objeksionet e saj në këtë takim, të cilat janë reflektuar në procesverbal dhe në vijim ka refuzuar të nënshkruajë procesverbalin e takimit. Bashkëlidhur procesverbalit të takimit ndodhet një akt i shkruar me dorë dhe i nënshkruar nga ankuesja, ku citohet: *“Kam refuzuar të firmos procesverbalin por kam kërkuar të më jepet një kopje e procesverbalit. Konfirmoj që e kam marrë një kopje të procesverbalit dhe kjo është arsyeja e*

vetme që po firmos, vetëm dhe vetëm për të marrë një kopje të procesverbalit por jo që jam dakord me pretendimet e kompanisë ose nuk pranoj arsyet e kompanisë, që paraqet në këtë procesverbal që të shkëpusë marrëdhëniet e punës me mua”.

Në vijim të takimit të sipërcituar, nëpërmjet shkresës së datës 06.05.2020, të Assist sh.p.k., ankueses i ndërpriten marrëdhëniet financiare në datën 06.07.2020. Në këtë shkresë theksohet fakti se mbështetur në nenin 143, paragrafi 5, i Kodit të Punës, gjatë periudhës 2 mujore të njoftimit, ajo ka të drejtën të përfitojë, së paku 20 orë leje të pagueshme në javë për të kërkuar një punë të re.

Shkresa “Njoftim” e datës 06.05.2020, të Assist sh.p.k., dërguar në adresë të ankueses është kthyer mbrapsht nga shërbimi postar me shënimin “objekt i pakërkuar”.

Referuar dokumentacionit të depozituar nga Assist sh.p.k në cilësinë e provës rezultojn se përveçse nëpërmjet shërbimit postar, shkresa “Njoftim” e datës 06.05.2020, të Assist sh.p.k., nëpërmjet së cilës ndërpriten marrëdhëniet e punës me ankuesen, i është dërguar kësaj të fundit nga ana e Zyrës së Burimeve Njerëzore të Assist sh.p.k. edhe nëpërmjet emailit, në datën 07.05.2020. Referuar këtij e-maili citohet: *“Bashkëlidhur këtij e-mail gjen një kopje të njoftimit mbi zgjidhjen e kontratës së punës. Pas takimit tonë pranë zyrës së burimeve njerëzore më datë 4 maj 2020, ora 11:15 origjinali i njoftimit është dërguar me postë rekomandë me letërmarrje në adresën e komunikuar ndaj shoqërisë.”*

Në këtë kontekst, Komisioneri gjykon se rrëzohet pretendimi i ankueses se nuk ka marrë asnjë dijeni dhe nuk disponon asnjë akt mbi largimin nga puna.

Mbështetur në provat e depozituara nga Assist sh.p.k. rezultojn gjithashtu se për shkelje të së njëjtës natyrë edhe punëmarrës të tjerë të kësaj shoqërie janë larguar nga puna, të tillë si R.C., L.K, A.T. etj. Çështjet lidhur me zgjidhjen e kontratës së punës janë bërë objekt shqyrtimi gjyqësor. Ndërkohë që, një tjetër punonjëse, përkatësisht SH.A. ka dhënë dorëheqjen, pasi Shoqëria ka konstatuar shkeljet përkatëse.

Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se në interpretim të nenit 7, pika 1, e LMD, kontrata e punës me ankuesen është zgjidhur si pasojë e shkeljeve të kryera. Në këtë kontekst, KMD vlerëson se ankuesja nuk është nënshtruar ndaj një trajtimi të padrejtë, disfavorizues e të pabarabartë.

Në mungesë të trajtimit të padrejtë, disfavorizues e të pabarabartë, nuk ka diskriminim për shkakun e pretenduar në ankesë.

3. Lidhur me mos lejimin e ankueses G.M. për të patur akses në ambientet e shoqërisë, pas dërgimit të njoftimit për zgjidhje së kontratës së punës.

Ankuesja G.M. pretendon se në datën 08.05.2020 është paraqitur në punë, por personeli përgjegjës i Assist sh.p.k nuk e ka lejuar për të patur akses në ambientet e punës. Referuar shkresës “Njoftim” e datës 06.05.2020, të Assist sh.p.k. marrëdhëniet financiare të ankueses me shoqërinë zgjasin deri në datën 06.07.2020. Por, njëkohësisht ankueses i është dhënë e drejta, në bazë të nenit 143, paragrafi 5, i Kodit të Punës, që gjatë periudhës 2 mujore të njoftimit, të përfitojë, së paku 20 orë leje të pagueshme në javë për të kërkuar një punë të re.

Përveçse nëpërmjet emailit të datës 08.05.2020, ankuesja i është drejtuar Assist sh.p.k. me shkresat e datave 08.05.2020 dhe 09.05.2020¹³, ku ndër të tjera kërkon shpjegime dhe sqarime mbi zgjidhjen e kontratës së punës, duke cilësuar faktin se nuk ka dijeni, si dhe lidhur me ndalimin e saj për të patur akses në zyrat e shoqërisë. Më shkresën e datës 13.05.2020, Assist sh.p.k. e sqaron ankuesen se lidhur me zgjidhjen e kontratës së punës, ajo është njoftuar nëpërmjet e-mailit të saj, në kushtet kur zarfi me shkresën përkatëse është kthyer mbrapsht nga shërbimi postar me shënimin “objekt i pakërkuar”. Njëkohësisht në shkresën e Assist sh.p.k theksohet fakti se, ai nuk është duke shkelur te drejtat e saj, por ankuesja me sjelljen e saj është duke kërkuar të krijojë një konflikt të pagënë, për të cilin këshillohet të heqë dore sa më parë. Në shkresën e Assist sh.p.k., e cila i është dërguar ankueses me e-mail citohet: *“Kështu sa lidhet me “zellin” tuaj për t’u paraqitur në punë, duam të sjellim në vëmendjen tuaj se për shkak të mungesave të paarsyeshme në datat.....ndaj jush është marrë masë disiplinore “vërejtje me shkrim”. Po kështu, arsyeja për të cilën është zgjidhur kontrata e punës me Ju ka lidhje me “shkelje të normativës për trajtimin e të dhënave personale” (verifikim tabulatesh të paautorizuara nga klienti), si dhe “rimbursime të kryera jashtë procedure” të kryera nga ana juaj dhe të verifikuara në operacionet me anomali të kryera përmes aplikacioneve Vodafone..... Së pesti, duam të sjellim në vëmendjen Tuaj, se marrëdhëniet midis punëdhënësit dhe punëmarrësit duhet të udhëhiqen nga parimi i mirëbesimit, për të cilin kemi konstatuar se Ju mungon, kjo lidhur me refuzimin për nënshkrimin e procesverbalit të takimit, leximin e gabuar që i bëni Njoftimit të datës 06.05.2020, obstruksionizmin e treguar në marrjen e njoftimeve të dërguara me postë, apo krijimit të një situatë konflikti artificial, si kjo e pretenduar me emailin tuaj të datës 08.05.2020 apo edhe të shkresave tuaja datë 08.05.2020 dhe 0-9.05.2020. Së fundmi, Ju informojmë se duke qenë se nuk po merrni më as njoftimet me postë, këtë shkresë do t’jua*

¹³ Këto shkresa i janë dërguar për dijeni edhe Inspektoriatit Shtetëror të punës dhe Shërbimeve Shoqërore dhe Degës Rajonale të ISHPSHSH-së Tiranë.

dërgojmë nëpërmjet emailit në adresën tuaj të treguar më sipër, duke Ju ftuar njëkohësisht që nëse dëshironi mund të tërhiqni kopjen në letër të saj, duke u paraqitur në zyrën e Burimeve Njerëzore të shoqërisë Assist sh.p.k., duke konfirmuar dhe marrjen në dorëzim të saj, si dhe të kopjes së Njoftimit datë 06.05.2020 të rikthyer nga posta shqiptare me shënimin “objekt i pakërkuar.”

Për sa më sipër, gjatë procedurave të ndjekura pranë KMD-së, Assist sh.p.k. ka theksuar faktin se ankueses i është kërkuar për t'u paraqitur në ambientet e punës për të marrë në dorëzim aktet e kthyer mbrapsht nga shërbimi postar me shënimin “objekt i pakërkuar”. Ajo është lejuar dhe ka patur lirish akses në zyrat e shoqërisë, ndërkohë që në datën 08.05.2020, znj. G.M. pretendon se nuk i është lejuar akses në ndërtesë. Assist sh.p.k. ka theksuar gjithashtu se ndërmjet kësaj shoqërie dhe ankueses është shkelur parimi i mirëbesimit, i cili është një ndër parimet kryesore në një marrëdhënie pune.

Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se thyerja apo shkelja e parimit të mirëbesimit në punë ndikon në marrëdhëniet punëdhënës – punëmarrës dhe shpeshherë përbën shkak për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës. Nga analizimi i provave dhe fakteve të depozituara nga palët rezulton se ky parim është thyer ndërmjet punëdhënësit dhe punëmarrësit, fakt që ka pasqyruar ashpërsimin e marrëdhënieve të tyre. Por, pavarësisht sa më sipër, Assist sh.p.k. nuk ka cënuar pagesën e ankueses deri në datën 06.07.2020, sikurse përcaktohet në shkresën përkatëse. Njëkohësisht, në shkresën e kësaj shoqërie, ankuesja ftohet për t'u paraqitur në punë në mënyrë që të merrte në dorëzim edhe shkresat e dërguara në adresë të saj, të cilat janë kthyer mbrapsht nga shërbimi postar me shënimin “objekt i pakërkuar”. Në këtë kontekst, KMD gjykon se nuk ka fakte dhe prova të mjaftueshme për të vërtetuar se ankueses i është ndaluar akses në ambientet e brendshme të Assist sh.p.k.

Në interpretim të nenit 7, pika 1, të LMD, Komisioneri gjykon se ankuesja nuk është ekspozuar ndaj një qendrimi të padrejtë dhe disfavorizues nga ana e Assit sh.p.k.

Në mungesë të trajtimit të padrejtë, disfavorizues e të pabarabartë, nuk ka diskriminim për shkakun e pretenduar në ankesë.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 1, nenin 7, pika 1, neneve 13 e 15, nenit 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a) e nenin 33, pikat 10-11, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të znj. G.M., për shkak të përkatësisë në një grup të veçantë, nga Assist sh.p.k.
2. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

Robert GAJDA

KOMISIONERI

Fusha – Punësim
Shkak – Përkatësi në grup të veçantë
Lloji vendimit - mosdiskriminim